



TREGU I SIGURIMEVE PYETJET MË TË SHPESHTA

Si të veproj për të paraqitur një ankesë?

Nëse je i pakënaqur nga shoqëria e sigurimit, duhet fillimisht të paraqisni një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit.

Shoqëria e sigurimit ka detyrimin të krijojë një sistem dhe procedura të brendshme për trajtimin e ankesave.

Nëse nuk keni marrë një përgjigje brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës apo nëse jeni i pakënaqur me përgjigjen që keni marrë, Ju mund të depozitoni ankesë pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Për informacione të nevojshme për depozitimin e një ankesë konsultoni ([Link Udhëzuesin për ankesat](#))

Kam siguracion të detyrueshëm për makinën time. Çfarë dëmsh mbulohen në rast aksidenti?

Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, për sigurimin e përgjegjësive së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik për dëmet që i shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti. Ky sigurim nuk mbulon dëmet që pëson mjeti shkatarr i aksidentit apo drejtuesi i këtij mjeti.

Si të veproj për të paraqitur kërkesën për dëmshpërblim në rast aksidenti?

Nëse keni pësuar dëm nga një aksident automobilistik dhe nuk keni qenë shkaktari i aksidentit duhet të depozitoni kërkesën për dëmshpërblim pranë shoqërisë së sigurimit ku ka qenë i siguruar mjeti shkaktar i aksidentit.

Kërkesa për dëmshpërblim mund të paraqitet brenda dy vjetësh nga momenti i aksidentit. Megjithatë rekomandojmë që të njoftoni shoqërinë e sigurimit përgjegjëse sapo të keni mundësi dhe të paraqisni kërkesën për dëmshpërblim.

Kërkesa për dëmshpërblim duhet të shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e saj. Për të marrë informacion mbi listën e dokumentacionit të nevojshëm konsultoni link [http://amf.gov.al/pdf/ligje/Rregullorenr_53_20180404_pdf\(Autosaved\).pdf](http://amf.gov.al/pdf/ligje/Rregullorenr_53_20180404_pdf(Autosaved).pdf). Gjithashtu Ju keni të drejtë të kontaktoni me shoqërinë e sigurimit apo ndërmjetësin në sigurime që Ju ka ofruar kontratën e sigurimit dhe të merrni udhëzimet e informacionin që ju nevojitet.

Kam policë të sigurimit shëndet në udhëtim. Nëse shkoj në një spital jashtë Republikës së Shqipërisë për të kryer një vizitë a më mbulon shpenzimet shoqëria e sigurimit?

Kontrata e sigurimit të shëndetit në udhëtim nuk mbulon shpenzimet spitalore të palnifikuara më parë. Kjo kontratë përgjithësisht mbulon shpenzimet spitalore për sëmundje akute, të menjëhershme si dhe aksidenteve personale, të cilat mund të ndodhin në mënyrë të papritur kur jeni duke udhëtuar përkohësisht jashtë Republikës së Shqipërisë.

Përpara se të nënshkruani kontratën e sigurimit lexoni me kujdes mbulimet dhe përjashtimet që janë të përcaktuara në kontratë.

Jetoj jashtë Shqipërisë dhe dua të vi për pushime në Shqipëri. Udhëtoj me makinën time. A duhet ta siguroj makinën në Shqipëri për ditët që do jem aty? Në rast aksidenti cfarë më mbulon siguracioni?

Në ligjin nr. 10076 datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, përcaktohet detyrimi se çdo mjet motorik me regjistrim të huaj që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë i paisur me dokument ndërkombëtar të sigurimit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (*karton jeshil*), të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rast se drejtuesi i mjetit motorik me regjistrim të huaj, nuk disponon një dokument ndërkombëtar të vlefshëm të sigurimit të përgjegjesisë ndaj palëve të treta (*karton jeshil*), atëherë ai është i detyruar të lidhë kontratë për sigurimin e përgjegjesisë nga përdorimi i mjetit motorik (*sigurim kufitar*), të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, me periudhë vlefshmërie, që mbulon periudhën e qëndrimit të tij, por jo më pak se 15 ditë.

Në rast se drejtuesi i mjetit nuk disponon as dokumentin ndërkombëtar të sigurimit (kartonin jeshil) dhe as sigurimin kufitar, ai nuk lejohet të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rast aksidenti nga përdorimi i mjeti motorik me regjistrim të huaj, i siguruar nga shoqëri sigurimi vendase me policë sigurimi kufitare, Ju lind e drejta të kërkonti dëmshpërblimin te shoqëria përgjegjëse e sigurimit, e cila ka lëshuar kontratën e sigurimit, ose te Byroja, nëse parashikohet ndryshe, deri në kufirin minimal të parashikuara në nenin 26 paragrafi 2 të ligjit nr. 10076, datë 12 shkurt 2009.

Dua të bëj një ankesë pranë Jush në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim të cilën gjykata ma rrëzoi.

Nëse kërkesa Juaj për dëmshpërblim është duke u trajtuar nga një Gjykatë në Republikën e Shqipërisë apo nëse ka një vendim gjyqësor për këtë çështje Autoriteti nuk mund të shqyrtojë në rrugë administrative ankesën e paraqitur nga ana Juaj, përse kohë që çështja ka kaluar në juridiksion të gjykatës.

Ky rregull është i përcaktuar edhe në nenin 5, pika 2 të Rregullores nr. 35, datë 28.05.2015 “Për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave”.

Kam blerë një makinë dhe dua të bëj sigurimin e mjetit. Ku të drejtohem?

Shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, të cilave mund t'i drejtoheni për sigurimin e mjetit i gjeni në linkun (http://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp).

Kam në pronësinë time një automjet të pajisur me Policën e Sigurimit Kasko. Automjetin e kam dhënë me qera tek një individ tjetër për përdorim. Në rast aksidenti përfitoj dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit?

Çdo individ, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit kasko, plotëson edhe formularin standard, në të cilin përcaktohet qartësisht se pas plotësimit të kërkesës për sigurim, i siguruari nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të

siguruesit. Në rast të moszbatimit të këtij kushti, siguruesi çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit.

Në kuptim të sa më sipër, nëse dhënia me qera e automjetit Tuaj është miratuar me shkrim edhe nga shoqëria e sigurimit, atëhere Ju përfitonit dëmshpërblim në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

A është e sigurt pagesa e primit të kontratës së sigurimit nëpërmjet një agjenti sigurimesh?

Për të qenë të sigurt për shërbimin e ofruar nga një individ që Ju paraqitet si agjent sigurimesh, Ju duhet t'i kërkonit tju tregojë licencën e dhënë nga AMF dhe marreveshjen me shoqërinë e sigurimit që tregon se ai po vepron në emër dhe për llogari të një shoqërie sigurimi. Gjithashtu nëse kryeni pagesa dhe shërbime nëpërmjet një agjenti sigurimesh, Ju duhet të siguroheni të merrni të gjitha faturat për pagesat e kryera.

Si ta verifikoj që një agjent në sigurime është i licencuar nga Amf?

Listën e agjentëve të licencuar nga AMF për ushtrimin e veprimtarisë në tregun e sigurimeve, gjendet e publikuar në faqen zyrtare të AMF në linkun "Rregjistri i të licencuarve".

Si mund ta marr informacionin nëse një familjar imi i sapo vdekur ka nënshkruar një policë siguracioni jete?

Në tregun e sigurimeve ushtrojnë veprimtari për sigurimin e Jetës tre shoqëri sigurimi, të cilat i gjeni në linkun (http://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp). Ju mund t'i drejtoheni këtyre shoqërive për informacion ose mund t'i drejtoheni AMF-së me një kërkesë zyrtare ose me anë të e-mailit amf@amf.gov.al, i cili mund të interesohet nën emrin tuaj.

Kam marrë një kredi në bankë, a kam të drejtë ta zgjedh unë shoqërinë e sigurimit ku do të sigurohem?

PO, ju si konsumatorë keni të drejtë të zgjidhni të kryeni sigurimin tek një nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në treg, e cila ju ofron mbulimin dhe çmimin më të mirë sipas kërkesave dhe nevojave tuaja. Gjithashtu nëse nuk jeni i kënaqur me një shoqëri të caktuar mund ta ndryshoni atë vitin pasardhës.

Çfarë është sigurimi?

Sigurimi është një kontratë me përmes të cilit personat transferojnë rrezikun tek shoqëritë e sigurimeve përkundërt pagesave të primit. Në rast të ndodhjes ngjarjes së parashikuar në kontratë të sigurimit, siguruesi (shoqëria e sigurimit) detyrohet të paguajë dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë apo në ligj.

Çfarë duhet të dini para se të firmosni një kontratë sigurimi?

Disa kontrata sigurimesh janë të ndërlikuara dhe mund të kenë pasoja financiare afat-gjata.

Kur të firmosni një kontratë sigurimi, merrni kohën e mjaftueshme për ta lexuar përpara se ta firmosni atë. Kërkojini paraprakisht agjentit apo brokerit në sigurime t'ju vërë në dispozicion të gjitha termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës, përlllogaritjet e kryera, shpjegime dhe çfarëdolloj informacioni tjetër ju duhet të dini.

Duke firmosur një kontratë sigurimi ju konfirmoni se jeni njohur me të gjitha termat dhe kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të kontratës, karakteristikat e sigurimit për të cilin jeni duke firmosur dhe dispozita të tjera kontraktuale.